



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

5641  
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 27.07.2015

U D H Ë Z I M

Nr. 23 , datë 27.07.2015

P Ë R

“ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË DHE TË MATURËS  
SHTETËRORE 2015, SESIONI I DYTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50 dhe 51 të Ligjit Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Vendimit të Këshillit Ministrave, Nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

U D H Ë Z O J:

KREU I

I. PROVIME KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2015, SESIONI I DYTË

1. Zhvillimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2015, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon:
  - a) *Gjuhë e huaj* 27.08.2015
  - b) *Gjuhë shqipe* 29.08.2015
  - c) *Matematikë* 31.08.2015
2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillojnë provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, në datën 25.08.2015.
3. Për Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2015, sesioni i dytë, ndiqen procedurat e përcaktuara sipas Urdhrit nr.119, datë 20.03.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë (Provime të Lirimit) 2015".

